



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 6 prot.

Kamëz, më 26 / 1 .2026

V E N D I M
Nr. 6 .Datë 26/1 2026
M B I

**“DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM PËR PËRDORIMIN E PRONËS PËR NGRITJEN
E STREHËZËS SË KAFSHËVE ENDACAKE NË BASHKINË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.1.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.05 Datë 20.1.2026 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.10465, prot., datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e Njërive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar”, Urdhërit të Drejtorisë së Mjedisit , Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor me nr. 11160 prot., datë 23.12.2025, “Për ngritjen e grupit të punës mbi përcaktimin e tokës për ndërtimin e strehëzës së kafshëve endacake”, si dhe në kuadër të realizimit të detyrave funksionale. Drejtoria e Mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së pëlqimit në parim për përdorimin e pronës në Zonën Kadastrale 2066, Nr. pasurie 24/4, pronë e Bashkisë Kamëz, ku sipërfaqja prej 1000 m² do të shërbejë për ngritjen e strehëzës së kafshëve endacake , sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor për nxjerrjen e Urdhërit, për përcaktimin e tokës për ndërtimin e strehëzës së kafshëve endacake dhe procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit, Kontrollit Veterinar dhe Ushqimor dhe Drejtori i Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYEFAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

